



Npi – 01/230 datë: 27.08.2021

Duke u bazuar në nenin 43 dhe 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi – 01/114 të datës: 26.04.2019, për mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të mbajtur më: 27.08.2021 është nxjerrë ky:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I M B L E D H J E S Ë - V I I I - T Ë R R E G U L L T T Ë K U V E N D I T T Ë K O M U N Ë S Ë S H T I M E S
E mbajtur më: 27.08.2021, (e premte) në ora 10.^{oo} h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: znj.Medina Brahaj, z.Perparim Ramusa, z.Shefki Dauti, z.Herolind Selmani, z.Reshat Mujota, z.Milot Deliu, znj.Fatmire Ferati, znj.Arbenita Halimi, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, znj.Valentina Halili-Ferati, z.Ruzhdi Jashari, z.Besnik Seferi, z.Fehmi Hysenaj, znj.Adelina Beqaj, z.Isak Muslija, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, dhe z.Rexhep Gashi. Në mbledhje përveq anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe: Kryetari, z.Naim Ismajli, Drejtortët: z.Hamëz Tërshani, znj.Agime Roshaj, nga ZKF-ja z.Bujar Ferati; Nga zyra Ligjore, z.Lulzim Muharremi, nga QKMF-ë znj.Arbresha Syla, Nga OJQ “Y A H R” z.Egzon Ahmeti, Nga zyra për Informim, z.Lulzim Sahiti e z.Gazmend Ademaj.

Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Kuvendit znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit Konstattoj, Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit.

Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.06.2021,
2. Pyetje – Përgjigje,
3. Kërkesë për transfer të mjeteve për bartje nga kategoria e rezervës në projekte kapitale,
4. Propozim-vendim për transfer dhe rialokim të ndarjeve buxhetore të projekteve Kapitale për vitin 2021,
5. Raporti i Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, nga Zyra Kombëtare e Auditorit (ZKA), Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve,
6. Prezantimi i Draft-Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2022-2024,
7. Rishqyrtimi i Vendimit mbi Statutin e QKMF “Vezir Bajrami” Shtime sipas kërkesës së MPL,
8. **Informatë nga DSHMS-ë për gjendjen me KOVID19, (Pikë shtesë)**

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapi diskutimin për rendin e ditës Kryesuesja e njoftoi Kuvendin lidhur me pikën shtesë të rendit të ditës, “Informatë nga DSHMS-ë për gjendjen me

KOVID19” e cila është kërkuar nga ju, lidhur me informatën për gjendjen e qytetarëve të komunës sonë me Kovid19, në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, ne në KPF-ë kemi kërkuar një pikë shtesë “Informatë për Kovid19”. Desha ta di sa ka afat me qëndruar si ushtrues detyre, meqenëse u bënë 6-7 muaj që në QKMF-ë kemi ushtrues detyre, me sa e di unë vetem 6 muaj ka një mundësi të tillë si UD.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, unë pajtohem me pikat e rendit të ditës, gjithashtu pajtohem edhe me pikën e 8 shtesë “Informatë nga DSHMS-ë për gjendjen me KOVID19”.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorimin prej 17 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitisht aprovoi Rendin e Ditës me pikën shtesë, “Informatë nga DSHMS-ë për gjendjen me KOVID19”.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 28.06.2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Naim Zejna; Unë kam një pyetje, se a do ti marrim të gjitha procesverbalet për këtë mandat, meqenëse e kemi ngritur shumë shpesh qështjen e mungesës së stafit në sektorin e Kuvendit?

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi Kuorimin prej 17 anëtarëve prezent në mbledhje.

Kuvendi i Komunës, unanimitisht aprovoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 28.06.2021.

Pika 2

Pyetje – Përgjigje

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Ruzhdi Jashari: Nuk kemi përgjigje në pyetjet tona, në teren na mbyti bërllogu, te lumi na mbyti era e fekaljeve, kjo pra është pasqyra katastrofale e komunës sonë. Kam pyetje direkte: Kur do të hiqen fekaljet nga Lumi shtimjanja?

z.Skender Hyseni: Përshëndetje, kam një falenderim të veçantë për Kryetarin dhe Drejtorin që kanë intervenuar në pastrimin e oborreve në fshatin Muzeqinë nga fekaljet. Kam këto pyetje: Çka po ndodhë, a do të ketë Subvencione për fermer për vitin 2021 apo jo? Pyetja tjetër është për drejtorin e shërbimeve publike, një pusëtë ka mbetur e hapur në trotuarin e fshatit Muzeqinë, a do të rregullohet? Dhe pyetja tjetër, a do të ketë këtë vit pastrim të shtratit të lumit Shtimjanja?

z.Herolind Selmani: Përshëndetje, unë kam këto pyetje: A është anuluar konkursi për ndarjen e bursave për Studentë, dhe pse nuk ka kaluar lista e përfituesve të bursave të përzgjedhur nga ana e Komisionit?

z.Naim Zejna: Kam këto pyetje: Pse janë marrë nxënës nën kriteret e përcaktuara nga Ministria te Gjimnazi dhe shkolla profesionale, si është gjendja? Te rruga “Komandant Kumanova” kur do të rregullohet gjendja e rrymës, sepse është shumë e keqe? Pyetje për ZKF-në a janë të pasqyruara mjetet prej 110€ te parapara nga Ministria e Arsimit për te shkolla Profesionale. A mirren ato mjete dhe ku janë të pasqyruara?

z.Rexhep Gashi: Kam këto pyetje: Pse nuk kemi përgjigje ne si assembleist në pyetjet tona të kaluara? Ne e kemi ngritur disa herë qështjen e Globit (Skulptura metalike) e cila ka kushtuar mbi 9000€, ne kemi pyetur se ku gjindet dhe qka do të bëhet me te, Kryetari ka thënë se do të vendoset para Muzeut, pse nuk është vendosur kjo dhe si eshte gjendja faktike e tijë? Pasqyret, në rrugët “12 Qershori” janë thyer disa pasqyre, pse neglizhohen qe 6-7 muaj për me i zëvendësuar?

z.Muhamet Ademaj: Kam këto pyetje: Cila është gjendja e furnizimit me ujë të pijes për muajt Korrik dhe Gusht? Dhe a ka pas rrezik diçka?

z.Besnik Seferi: Përshëndetje, unë kam këto pyetje: Sa i përket asfaltimit të rrugëve, së fundmi janë duke u asfaltuar shumë rrugë, a është në projekt rruga “Kuvendi i Arbërit” kur dihet se ajo ka qenë e asfaltuar, por është prish për shkak të rregullimit të një gypi? Po ashtu dua ta di rruga “Skënderbeu”

a është në projekt për asfaltim sivjet apo jo? Edhe shtyllat elektrike dihet se janë të stërngarkuar me kablla, a është ndërmarrë diçka për to?

z.Hamëz Tërshani, drejtor i DSHP; Përshëndetje, Kompanitë publike është e vërtetë që kanë pasë mbingarkim, mirëpo ka pasë punë dhe është duke u punuar, me një fjalë janë në nivel të detyrës së tyre.

z.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Këto mjete janë tërhequr nga Qeveria për Kovid19.

znj.Agime Roshaj, drejtoresh e DKA; Përshëndetje, Konkursi për ndarjen e bursave do të rihapet, dhe sigurisht që do ta keni një informatë për ecurinë e sajë. Ministria e arsimit na kanë gthënë se do të ndajnë mjetet për kokë nxënësi.

Kryetari, Naim Ismajli; Përshëndetje, ne po dëgjojmë në medie gjoja për rritjen e buxhetit nga Qeveria, mirëpo për asnjë rast të vetëm Qeveria nuk ka ndarë mjete financiare, por këto janë më tepër deklarata populiste. Nuk ka asnjë shtim të buxhetit. Ju do ta shihni vetë se Studentët do ti marrin me kohë bursat, dhe kanë me u respektuar kriteret. Disa pyetje do ti merrni me shkrim, sepse kërkojnë një trajtim më të detajuar.

z.Ruzhdi Jashari; Kjo që thua ti (kryetar) është vetëm një bllof, nuk ka përtgjigje në pyetjet tona si psh. nuk ka ujë në shkollën fillore në fshatin Petrovë, e shumë të tjera. Kërkoj nga ti mos me më ndërpre në diskutimin tim, kërkoj nga Kryesuesja që me qitë jashtë Kryetarin, sepse po pengon në diskutim, ky nuk është mbret këtu.

z.Herolind Selmani; Unë po i lexoj rekomandimet e Komisionit, dhe këtu nuk thot që me e anuluar konkursin, por me siguri e keni bërë sepse aty nuk ka hy dikush që keni dashur.

z.Fehmi Hysenaj; Ne kemi bërë zgjedhjen më meritorë, por unë po propozoj që pa u ndryshuar rregullorja mos me u shpallë konkursi.

Pika 3

Kërkesë për transfer të mjeteve për bartje nga kategoria e rezervës në projekte kapitale

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Ferati.

znj.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Përshëndetje, Në vazhdim Zyrtari Kryesor Financiar lexoi dokumentin me shifra konkrete sipas tabelave. (shih dokumentin) Në fund delegatët i ftoi që ta votojnë. Nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

z.Ruzhdi Jashari; Ne komentet i kemi dhënë në mbledhjen e KPF-së. Qështja e adresimit dhe e specifikimit të projekteve ka qenë kërkesë e jona e vazhdueshme. Mirë është që edhe Ministria i ka kthyer mbrapa vendimet mu për shkak të mos-specifikimit të duhur të projekteve. Patjetër duhet me ditë qytetarët se kah po shkojnë investimet e projekteve. Ne prap edhe sot po kërkojmë që projektet të specifikohen sepse kushtet janë rrugët i kemi emërtuar. Duke mos i specifikuar projektet është bërë dallavere me projekte, dhe vazhdon te bëhet ende.

z.Naim Zejna; Ne i patëm disa kërkesa në KPF-ë, kemi kërkuar përveç të tjerash edhe që projektet të specifikohen edhe pak më shumë.

znj.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Një sqarim të vogël, këto kërkesa të Ministrisë i kemi analizuar mirë, dhe i kemi harmonizuar, ndërkaq në PIP kanë me hy me shkurtesa, sepse nuk i nxen tabela.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi se janë 20 delegatë prezentë në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 17 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 3 vota “Abstenim”, aprovoi vendimin për transferin (bartjen) e mjeteve financiare nga kategoria e rezervës buxhetore komunale, në projekte kapitale.**

Pika 4

Propozim-vendim për transfer dhe rialokim të ndarjeve buxhetore të projekteve Kapitale për vitin 2021

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Ferati.

znj.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Në vazhdim lexoi dokumentin sipas tabelave. (shih dokumentin) Nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

z.Ruzhdi Jashari; Çështja e shkollave si ajo në Carralevë e “Lasgush Poradeci” në Muzeqinë, nuk po dihet se çka po ndodhë, nuk kemi informata, për shkollën e Carralevës kemi nda 4 herë mjete financiare, mbi 90.000€ kemi nda mjete për inventar, kemi kërkuar informatë që ta dimë se sa ka investuar Ministria, e sa përqind ka marrë pjesë Komuna në këtë projekt. Është e pa justifikueshme me kërkuar prap mjete, ky projekt duhet me u hetuar nga një komision i Kuvendit. Unë kërkoj hetim.

z.Perparim Ramusa; Te kjo pikë duhet ta sqarojmë se ka mbetje të mjeteve financiare, duhet ta sqarojmë për shkak të qytetarëve, se këtu jemi duke marrë e jo duke dhënë. Këto mjete unë propozoj që një pjesë e tyre të alokohen për shkollën e Davidovcit, edhe pse ju si DKA besoj se e dini më mirë se ku në cilën shkollë ka nevojë më shumë për të investuar.

z.Naim Zejna; Është e vërtetë ajo që tha parafolësi, sepse ne në KPF kemi kërkuar që të formohet një komision me qëllim që të adfresohet mirë se në cilën shkollë ka nevojë më shumë, le të dihet se për cilat shkolla po ndahen mjetet, sepse kemi shkolla shumë.

Kryetari, Naim Ismajli; ZKF-ja ishte i qartë, se këto mjete janë mbetje, dhe ne jemi të obliguar që të bazohemi në paramasë dhe parallogari, nuk kemi një çmim strikt. Shpesh here i kemi minimum 20% më lire. Tash kemi një kontigjent, që Kuvendi vendosë nëse don me i destinuar dikund ose ato mjete kan me u kthyer në Suficit. Nuk mund të themi tani se cila shkollë do të jetë përfituese, sepse secila shkollë ngapak ka nevojë. Ne jemi okej me procedurat. Kjo shihet edhe nga raporti i Auditorit.

znj.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Dua të jap një sqarim, se miratimi i këtij projekti na mundëson që buxhetin e vitit 2022 ta planifikojmë më mirë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi se janë 18 delegatë prezentë në mbledhje.

* **Kuvendi i Komunës, me 9 vota “Për” me 5 vota “Kundër” dhe me 4 vota “Abstenim”, aprovoi vendimin për transfer dhe rialokim të ndarjeve buxhetore të projekteve kapitale për vitin 2021.**

Pika 5

Raporti i Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtimes për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020, nga Zyra Kombëtare e Auditorit (ZKA), Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Ferati.

znj.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Ajo që duhet ta them që në fillim është se opinion i Auditorit Gjeneral është “ i pa modifikuar “. Në vazhdim lexoi një pjesë të raportit të cilin tha se e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, prandaj unë pres nëse ka ndonjë pyetje nga ju, do të përgjigjem.

z.Ruzhdi Jashari; Është tepër e ndieshme kur diskutojmë për raportin e auditorit, kur e dime se opinionimi i tij është dhënë në bazë të pak mostrave që ka marrë, por nëse mirren mostra tjera sikurse është rasti te shpronësimet do ta kishim një raport krejt tjetër. Raporti është obligativ për Komunën pse me e diskutuar ne kur nuk mund ta ndryshojmë. Komuna duhet me e bërë planin e zbatimit të rekomandimeve të cilin mund ta diskutojmë e ta ndryshojmë. Unë jam “Kundër” sepse ka aq shumë parregullsi sa që duhet me shku në prokurori. Ka 6 të gjetura që kanë rekomandime e që nuk janë zbatuar fare. Krejt e dimë se si e kemi gjendjen në komunë, nuk ka lavdara këtu por ka vetëm keqmenaxhim në të gjitha fushat.

z.Naim Zejna; Po diskutojmë për një raport që vjen prej një organi të pa varur. Cila është vlera nëse e votojmë “Për” ose “Kundër”. Ne duam ta dimë se sa janë zbatuar rekomandimet e auditorit. Kemi edhe konkluzione që fatkeqësisht i shohim për herë të parë. Opinioni “ i pa modifikuar “ nuk nënkupton notën 5. Në masë të madhe nuk janë zbatuar konkluzionet. Ne do të abstenojmë sepse raporti është i bazuar në 2-3 mostra, dhe nuk thellohet pak më shumë. Unë nuk jam i kënaqur me opinionin e auditorit.

z.Fehmi Hysenaj; Unë e kam lexuar raportin, dhe shihet që opinioni është i mirë. Shqetësuese është se të gjeturat nuk janë pak më të vogla, por madje kemi edhe të përsëritura, dhe opinioni i Auditorit nuk ka ndryshuar.

z.Rexhep Gashi; Raporti i auditorit është i pavarur. Disa thanë se raporti është i mirë, po ashtu u tha më herët se nuk duhet të votohet, e tash kthehen dhe thojnë se duhet të votohet. Pikërisht auditori ka gjetë shkelje te Komisioni për ndarjen e subvencioneve, që është shumë e ndieshme.

z.Perparim Ramusa; Unë propozoj që raporti të kalojë në Kuvend. Unë po quditem me kolegun paraparak që po përpiqet të ndikojë në raportin e organit të pavarur.

z.Shefki Dauti; Raportin e auditorit duhet ta marrim si të mire, dhe e konsideroj si ndihmë për Kuvendin. Auditori i ka mekanizmat e tij të vlerësimit. A mundemi ne me e ndryshuar këtë raport, jo prandaj ne është mire me diskutuar për të gjeturat se a janë zbatuar apo jo.

z.Fehmi Hysenaj; Në raportet e auditorit që i kemi diskutuar më herët unë kam thënë se ne duhet me e votuar Planin për zbatimin e rekomandimeve.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi se janë 17 delegatë prezentë në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, me 9 vota “Për” me 2 vota “Kundër” dhe me 6 vota “Abstenim”, aprovoi Raportin e Auditorit të përgjithshëm për vitin 2020, lidhur me planin për zbatimin e rekomandimeve.**

Pika 6

Prezantimi i Draft-Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2022-2024

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Bujar Ferati.

znj.Bujar Ferati, Zyrtar Kryesor Financiar; Meqenëse Draft-Planit Buxhetor Komunal për periudhën 2022-2024, duhet sipas ligjit të shkojë në diskutim publik, unë po e prezantoj vetem në pikat kryesore, sepse do të kemi rast që ta diskutojmë bashkarisht në detaje. Baza ligjore ekziston dhe është e prezantuar në dokumentin e shkruar të cilin e keni marrë me kohë dhe besoj e keni lexuar. Në vazhdim prezantoi kodet buxhetore sipas tabelave. Unë i mirëpres pyetjet e juaja nëse keni. Ju ftoj që ta votoni vendimin për diskutim publik.

z.Shefki Dauti; Planit Buxhetor për vitin 2022, ka me shku në debat publik, unë po kërkoj që debate të bëhet më gjithëpërfshirës, keni mundësi që ta dërgoni në formë të shkruar. Mos të krijojmë paranoja, se me buxhetin që e kemi mund të arrijmë efektet e një buxheti prej 20 milion, sa për të bërë fushatë. Dita e votimit, kërkoj që të jetë vetëm votim formal “për” ose “kundër” e jo ta zgjasim diskutimin me propozime të kota.

z.Besnik Seferi; Unë po pajtohem që të shkojë në diskutim publik. Kërkojmë që në buxhet të futet edhe pagesa për nënat në shumën prej 100€ për çdo fëmijë të lindur, ky nuk është projekt i fushatës por ne kemi kërkuar që dy vite radhazi. Edhe për këtë projekt nuk ka asnjë pengesë ligjore. Unë besoj se duhet ta kalojmë në Kuvend.

z.Fehmi Hysenaj; Unë mendoj se duhet me kalu ky buxhet. Sa i përket debatit publik kërkoj që të organizohet më mirë dhe kërkoj seriozitet më të madh të KPF-së.

z.Ruzhdi Jashari; Pajtohem që të shkojë në diskutim publik. Te rekomandimi i KPF-së, propozimi jonë ka shkuar si pjesë integrale e debatit të buxhetit, e jo siç e keni shkruar e keni pshjtjellë për me diskutu, kur KPF-ja ka thënë se propozimi do të jetë pjesë e dokumentit.

z.Muhamet Ademaj; Unë po kërkoj që ekzekutivi ta organizojë më mirë debatin publik.

z.Naim Zejna; Në KPF-ë kemi kërkuar që të bëhet një krahasim me buxhetin e mëparshëm. Ne si grup parlamentar i LDK-së, kërkojmë që të realizohet në tërësi projekti i amfiteatrit, të kinemasë verore. Pastaj rregullimi i trotuarit dhe sanimi i tollovisë para shkollës “Emin Duraku”, kërkojmë që të ketë pozicion të çartë buxhetor. Po ashtu duhet të kemi parasysh faktin se jemi të ngarkuar me pozicionin buxhetor “Detyrimet Kontigjente” kemi vonesa por fatura do të na vjen sot ose nesër. E përkrahu propozimin që KPF-ja të përfshihet aktivisht në debat si dhe përfaësuesit e grupeve parlamentare.

z.Perparim Ramusa; Puna më e vlefshme e Kuvendit është miratimi i buxhetit. Unë propozoj që të merren parasysh secili propozim.

Kryetari, Naim Ismajli; Do ti ftoj për debat secilin grup parlamentar dhe secilin anëtar të Kuvendit që të dikutojmë për planin buxhetor prej sot deri më 30, dhe do ti kordinojmë datat. Mundësitë i keni të barabarta. Do tju bëj ftesa zyrtare. Nuk ka mundësi të bëhet buxhet partiak, sepse sot në secilën shtëpi janë të përtzier politikisht.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi se janë 18 delegatë prezentë në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitisht, aprovoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik Planin Buxhetor të Komunës së Shtimes për vitin 2022, për afatin prej 15 ditësh. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Zyra Komonale për Financa në bashkëpunim me Zyrën për Informim, dhe Komitetin për Politikë dhe Financa.**

Pika 7

Rishqyrtimi i Vendimit mbi Statutin e QKMF “Vezir Bajrami” Shtime sipas kërkesës së MPL

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Sqaroi se lidhur me këtë pikë e kemi edhe miratimin e Ministrisë, dhe nuk kemi problem që të vazhdojmë me emrin e njejtë “Dr.Vezir Bajrami” – Shtime. Në vazhdim Kryesuesja hapi diskutimin për këtë pike. Meqenëse diskutime nuk kishte Kryesuesja Konstatoi se janë 18 delegatë prezentë në mbledhje.

*** Kuvendi i Komunës, unanimitisht vendosi të konfirmojë, vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-0/149 të datës: 03.06.2021, për aprovimin e Statutit të QKMF-së në Shtime, me emërtimin “Dr.Vezir Bajrami”.**

Pika 8

Informatë nga DSHMS-ë për gjendjen me KOVID19. (Pikë shtesë)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Arbresha Sylja.

znj.Arbresha Sylja, U.D. e QKMF; Unë me këtë rast po e zëvendësoj drejtorin e QKMF-së z.Musa Baftiun, i cili nuk është këtu. Në vazhdim lexoi informatën, të cilën tha se e keni marrë me kohë. (Shih dokumentin) nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur.

z.Naim Zejna; 401 raste qenkan aktive me Kovid19, mua më shqetëson fakti sepse ky numër ka qenë në nivel të Kosovës. Qka po ju rekomadoni këtyre të prekurve me Kovid19? Ku qëndrojmë me vaksionim karshi popullatës së Kosovës? Pastaj a është kryer dezinfektimi dhe deratizimi në komunën tonë.

Kryetari, Naim Ismajli; Po janë kryer.

z.Naim Zejna; Unë i kam pa se nuk janë kryer, e disa janë bërë shkel e shko.

Kryetari, Naim Ismajli; Disa mund të jenë në proces.

z.Naim Zejna; Ka dështuar organizimi i mirë, mënyra se si e kanë bërë në shkollë ku punoj unë ka qenë nën çdo nivel, ne ishim prezent në klasë kur e bënë duke na thënë ngritni këmbët vetem pak.

z.Fehmi Hysenaj; Gjendja është e rënduar, dhe masat nuk po respektohen. Po bëj thirrje te qytetarët se duhet ruajtur shëndetin. Të gjithë po bëjmë thirrje për vaksionim, e në anën tjetër ka pengesa.

z.Besnik Seferi; Mirë që e marrim si raport, mirëpo mua po më shqetëson çështja e furnizimit të qytetarëve me barna. Kontrollohesh te mjeku e barnatoret e mbyllura, thjeshtë nuk mundesh me i barnat. Unë po kërkoj që të bëhet një zgjidhje.

z.Ruzhdi Jashari; E kemi një raport, 361 raste pozitive. Disa qështje që lidhen me DSHMS-në dhe aspektin financiar, por ka disa çështje që nevojitet vetem vullneti dhe angazhimi, siç është mbajtja e pastërtisë, dezinfektimit, deratizimit e vaksionimit që ndikojnë direkt në këtë çështje. Vaksionimi është për tu përshëndetur në krahasim me disa komuna të tjera. Mirëpo nuk ka vend për vetëkënaqësi. Desha ta bëj pyetjen se a është vaksionuar krejt stafi i QKMF-së, sepse është shumë me rëndësi që edhe stafi me u vaksionuar, gjithashtu edhe stafi Arsimor? Këto çështje duhet shikuar seriozisht e jo

me marrë rroga badihava. Ministria nuk e pengon askend për me hjekë berllogun edhe me majtë pastërtinë, që po tentohet këtu që të hedhet fajit lartë.

z.Shefki Dauti; Flm.për raportin, edhe për stafin shëndetësor. Çështje sfiduese është çështja e vaksionimit të banorëve të komunës tonë. Posaqërisht duhet me u vaksionuar mësimdhënësit, unë i kamë marrë të dy dozat.

z.Perparim Ramusa; Faleminderit për informatën, është vërtetë një informatë reale. Stafi shëndetësor janë lodhur por edhe përkundër kësaj lodhje Qeveria edhe shtesat janë ndalë. Tallje me vendimin e Qeverisë për 60 €; Unë kërkoj që të shtohet numri i stafit dhe infermerisë që për 12 orë pune i marrin 400€

z.Muhamet Ademaj; Sa ka kapacitet QKMF-ja në Shtime që nëse rritet numri i të infektuarve, për me bërë vizita shtëpiake?

z.Fehmi Hysenaj; Ne është mirë me bërë thirrje për sigurimin e vaksinave të mjaftueshme për të gjithë banorët, po ashtu është mirë që të bëjmë thirrje, që secili banorë të vaksionohet.

z.Ruzhdi Jashari; Janë 3000 që janë vaksionuar me dozën e dytë, ka që janë vaksionuar më herët, ose që janë vaksionuar dikund tjetër. Është mer rëndësi që vaksionimi po vazhdon, edhe unë i bashkjëngjitem thirrjes për vaksionim.

z.Skender Hyseni; Kam një pyetje, unë e kam kryer Covid19, çka duhet me bërë ne që e kemi kryer?

znj.Arbresha Sylja, U.D. e QKMF; Shteti ka dështuar totalisht, në menaxhimin e pandemisë, kjo është e vërtetë. Vizitat shtëpiake edhe gjatë pandemisë nuk janë ndërprerë. Me barna esenciale është e obliguar Ministria për me na furnizuar e që nuk e bënë këtë. Te rastet e vaksionimit e kemi edhe ekipën mobile. Për vaksionim Ministria ka bërë ndarje për grupe të caktuara. Ne duhet me i ruajtë dozat për vaksionimin e dytë. Në QKMF-ë ka nevojë për staf shtesë.

Kryetari, Naim Ismajli; Po jap disa të dhëna me rëndësi, 309 mësimdhënës janë të vaksionuar. Shtabi emërgjent e ka bërë identifikimin. DZD-ja është bërë në të gjitha shkollat. Kapacitetet komunale janë që mund t'a përballojnë secilën gjendje që mund të bllokohet nga niveli qendror. Thirrja për vaksionim i Qeverisë, dhe procesi i menaxhimit të pandemisë janë shumë larg njëra tjetrës. Nuk ka doza të vaksinave dhe nuk ka termine. Problem kemi gjithashu edhe me Ministrinë e arsimit, nëse ka raste me Covid si do të veprohet, ose ratet e infektimit të mësimdhënësve si do të zëvendësohen. Si Shtab ne i kemi adresuar këto çështje dhe do ti bëjmë publike. Zgjidhja është një pako emërgjente për Covid19, si dhe pako për zgjidhjen e problemit të zëvendësimit të arsimtarëve. Të lihen të lirë Komunitat dhe të furnizohen me doza të mjaftueshme të vaksinave, kurgjë më shumë.

z.Naim Zejna; Fillimisht dëshiroj që Fehmiut ti shprehim ngushllime për humbjedn e djalit të agjës si dhe ngushllime u shprehim familjarëve të zyrtarit policor Hasan Hysenaj nga fshati Petrovë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Në emër të Kuvendit të Komunës së Shtimes i shprehim ngushllime familjes Hysenaj për humbjen e djalit respektivisht, zyrtarit policor Hasan Hysenaj.

Ju falënderoj për diskutimet, dhe për pjesëmarrjen e juaj në mbledhjen e Kuvendit, meqenëse diskutime tjera nuk ka mbledhjen e përfundoj në ora 12.10h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

